



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik***

**PROCESVERBAL**

Tiranë, më 15.04.2019, ora 11:00

**Drejton mbledhjen:**

**Milva Ekonomi - nënkryetare e Komisionit**

**Rendi i ditës:**

Seancë dëgjimore me drejtues të RTSH-së për shqyrtimin e Raportit të veprimtarisë vjetore të RTSH-së për vitin 2018.

**Marrin pjesë:**

Milva Ekonomi, Fidel Ylli, Musa Ulqini, Vilma Bello, Lindita Nikolla, Mirela Kumbaro, Ismet Beqiraj, Fadil Nasufi, Adelina Rista, Bujar Çela, Almira Xhembulla.

**Mungojnë:**

Enada Kapllani.

**Të ftuar:**

Kristaq Traja- Kryetar i KDRTSH-së,

Thoma Gëllçi – drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së,

Pandi Madhi - Kryetar i Bordit të Administrimit të RTSH-së.

## HAPET MBLEDHJA

**Milva Ekonomi** – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Faleminderit që jeni sot këtu!

Fillojmë mbledhjen e radhës së Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik. Sot kemi seancë dëgjimore me drejtuesit e RTSH-së për shqyrtimin e Raportit të veprimtarisë vjetore të RTSH -së për vitin 2018.

Të ftuar kemi zotin Kristaq Traja, kryetar i KDRTSH-së, zotin Thoma Gëllçi, drejtor i Përgjithshëm i RTSH-së dhe zotin Pandi Madhi, kryetar i Bordit të Administrimit.

Mendoj që ta ndajmë punën në dy pjesë: në pjesën e parë të lëmë përfaqësuesit të bëjnë një shpjegim për veprimtarinë vjetore të vitit 2018 dhe, më pas, të dëgjojmë një opinion nga relatori i komisionit, zoti Ulqini, në lidhje me aktivitetin. Pjesa tjetër do të jenë pyetje dhe komente në lidhje me prezantimin që do të bëjnë përfaqësuesit e RTSH-së.

Dua t'ju bëj me dije se raportin vjetor e kemi marrë disa ditë më parë, kemi pasur kohë ta shikojmë. Ndërkohë, Shërbimi i Monitorimit ka bërë vëzhgimin e tij për raportin dhe ka sjellë komentet. Kështu, e gjithë struktura e dëgjësës është e kompletuar, si nga pikëpamja e informacionit, ashtu edhe nga pikëpamja ligjore që duhet të bëjë komisioni ynë për zbatueshmërinë e kontrollit parlamentar.

Ftoj përfaqësuesit e Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit të fillojnë prezantimin për Raportin vjetor të RTSH-së, për vitin 2018.

**Kristaq Traja** – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Ashtu siç e thatë, ju e keni marrë raportin dhe unë nuk mund të shtoj ndonjë gjë të madhe, por më lejoni të heq vetëm një merakun tim.

Më lejoni t'ju kërkoj ndjesë publikisht për një vonesë në përgjigje ndaj rekomandimeve të Kuvendit, që u ngrit nga Kryetari i Kuvendit, zoti Gramoz Ruçi, ku thuhet: “RTSH-ja nuk ka sjellë përgjigje për rekomandimet e parlamentit”. Është e vërtetë, për një gabim njerëzor. Kjo duhet të vinte me raportin. Nuk ka ardhur dhe për këtë ju kërkoj ndjesë dhe përgjegjësinë e mbaj unë. Fakti është se të gjitha rekomandimeve të Kuvendit, ne u jemi përgjigjur në mënyrë specifike dhe një për një. Besoj se është e kuptueshme që këto janë detyra afatgjata, që implikojnë jo vetëm kohën, por edhe burimet financiare, por kjo është një tjetër histori.

Raporti, në tërësinë e tij, është përshkrim i punës në aspektin administrativ, teknik dhe teknologjik dhe, siç e thashë, i shtrirë në distancë kohore. Për këto gjëra drejtori i Përgjithshëm

është më kompetent dhe është në punën e tij të përditshme, dhe mund t'i thotë gjërat në mënyrë të hollësishme, madje edhe në përgjigje të pyetjeve që eventualisht mund të bëhen.

Nuk besoj se kjo do të ndodhë më me përgjigjet ndaj rekomandimeve të Kuvendit. Unë ju siguroj plotësisht. Nuk është çështje thjesht shpërfilljeje, larg këtij mendimi, por gabime njerëzore bëhen, për të cilat edhe unë jam përgjegjës.

Së fundi, kam një sugjerim, besoj se raportet që bën RTSH-ja, për shkak të specifikës që ka, duhet të jenë të njëtrajtshme në raport me rekomandimet. E kuptoj se ka edhe institucione të tjera të pavarura, por këto janë agjenci shtetërore, buxhetore dhe parlamenti ka të drejtë të kërkojë në mënyrë të drejtpërdrejt, ashtu si edhe ne.

Mendoj se liria e medias e ngjyros tablonë. Kjo nuk do të thotë të mos përgjigjemi, sepse e kemi detyrim kushtetues të raportojmë në Kuvend. Unë jam i hapur për pyetjet që mund të bëni.

Faleminderit!

**Thoma Gëllçi** – Faleminderit, zonja drejtuese e komisionit!

Edhe unë bashkohem me ndjesën e kryetarit, që për shkak të një gabimi teknik në raportin e dorëzuar në fillim, nuk ishte e përfshirë shtojca me përmbushjen e detyrimeve që vinin nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë në lidhje me detyrat e RTSH-së për vitin 2018. Pavarësisht se kjo ishte një çështje thellësisht teknike dhe gabim njerëzor, i cili u korrigjua menjëherë sapo u konstatua, përsëri më duhet të kërkoj ndjesë përpara deputetëve të nderuar të këtij komisioni parlamentar!

Theksoj me forcë se vonesa e dorëzimit të materialeve nuk është në asnjë mënyrë mungesë respekti në marrëdhëniet me parlamentin, por thjesht një gabim njerëzor, për të cilin mbajmë përgjegjësi dhe premtojmë se nuk do të përsëritet më në të ardhmen.

Ashtu siç e tha edhe kryetari, detyrat e lëna nga rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë kanë qenë në qendër të punës së RTSH-së për vitin 2018 dhe në shpjegime më të zgjeruara dhe të hollësishme janë pasqyruar në raportin që keni përpara.

Në këtë raport, të gjerë dhe të hollësishëm, përfshihet një paraqitje e gjerë dhe e hollësishëm e gjendjes ekonomike financiare; një analizë e njësisë së lajmeve dhe emisioneve tematike, në përgjigje të platformës editoriale, por edhe të kërkesave dhe shqetësimeve të popullatës; një këndvështrim i gjithanshëm lidhur me programet në kanalet gjeneraliste dhe tematike, të cilat gjatë këtij viti jo vetëm janë shtuar në sasi, por kanë pësuar edhe një transformim cilësor, si një domosdoshmëri për t'iu përgjigjur jo thjesht kërkesave në rritje të publikut, por edhe nevojës për një konsolidim të vazhdueshëm të rrugës për ndryshimin që po realizon RTSH-ja; një raport i njësisë teknike, e cila ka vijuar me investimet në prodhim dhe

transmetim, si dhe disa raporte të departamenteve të tjera, angazhimi i të cilave është harmonizuar gjithnjë edhe më shumë me njësitë bazë; një pasqyrë të punës në stacionet lokale e të tjerë.

RTSH-ja gjatë vitit 2018 e ka konceptuar dhe realizuar punën e saj si një sfidë për realizimin e detyrave të vështira, që lidhen me një qasje të re ndaj publikut. Paketa e ndryshuar dhe në rritje e programeve, e realizuar në vitin 2017, është pasuruar më tej gjatë vitit 2018. Një kanal i ri informativ dhe disa kanale të reja, që tashmë nuk janë më teste, por në programacion të plotë, janë në transmetim. Këto janë një pjesë e një përpjekjeje që vazhdon në rrugën e vështirë të transformimit.

Në një vështrim të përgjithshëm mund të themi se periudha janar-dhjetor 2018 ka qenë një periudhë e ndërtuar mbi sfidat të njëpasnjëshme. RTSH-ja tashmë është në periudhën e përmirësimit të produktit radioteleviziv. Ky proces ka kaluar në shumë faza dhe ka mbërritur këtu ku është sot. Të gjitha programet e RTSH-së janë transformuar në formë dhe në përmbajtje, duke sjellë një frymë të re në radio dhe në television, bazuar në standardet më të larta të transmetimit. Ka një rritje të ndejshme të besimit të publikut në programet dhe në lajmet e RTSH-së. Është pranuar nga të gjithë që RTSH-ja ka një ndryshim rrënjësor në formën dhe në përmbajtjen e saj; ajo tashmë nuk është thjesht një kanal i dobët, por një platformë e fuqishme, ku shqetësimet dhe problemet e popullit po zënë vend çdo ditë e më tepër.

Vitin e kaluar startuam dy emisione investigative shumë premtuese për të ardhmen, jo vetëm për rritjen e nivelit të gazetarisë serioze në RTSH, por edhe në forcimin e besimit që partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë kanë tashmë te ne. Kështu mund të përmend emisionin “31 minuta” në bashkëpunim me Qendrën e Gazetarisë Cilësore dhe në bashkëfinancim me ambasadën e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, me ambasadën e Mbretërisë së Holandës dhe RTSH-së.

Raportet e Bashkimit Europian, të përfaqësuesve të tyre këtu për RTSH-në janë të mbushura me vlerësime të merituar për reformën e thellë strukturore që është kryer, si dhe për impaktin tejet pozitiv që kanë pasur këto reforma strukturore në rritjen e cilësisë së ofertës televizive të saj.

Për herë të parë Bashkimi Europian ka ofruar një program bashkëpunimi me RTSH-në, ku përfshihet alokimi i disa fondeve për disa programe të rëndësishme në RTSH, siç janë ato për mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen e konsumatorit, si dhe kanë planifikuar fonde për akademinë e RTSH-së në bashkëpunim me Departamentin e Gazetarisë të Universitetit të Tiranës, ku Bashkimi Europian merr përsipër financimin e intershipëve të studentëve të gazetarisë, që duan të promovojnë dhe provojnë veten në RTSH.

Gjithashtu, për herë të parë një nukël e akademisë EBU-së do të hapet në bashkëpunim me akademinë e RTSH-së këtu në Tiranë.

Për herë të parë në historinë e progresraporteve për Shqipërinë nuk ka kritika për RTSH-në, por vlerësohet puna e Radiotelevizionit Shqiptar në forcimin e pavarësisë dhe në rritjen e profesionalizmit.

Në progresraport, e kemi theksuar edhe vitin e kaluar, thuhet: “Transmetuesi i shërbimit publik, RTSH-ja, ka një strukturë të re të brendshme, që pasqyron procesin e kalimit digjital. RTSH-ja ka zhvilluar dhe miratuar parimet territoriale për t’u mbrojtur ndaj ndërhyrjeve politike”. Raporti i OSBE/ODIHR-it në zgjedhjet parlamentare të qershorit deklaroi se RTSH-ja tregoi një qasje të ekuilibruar në raportimin e fushatës.

Një nga detyrat e lëna në këtë progresraport, ku përfshihet edhe RTSH-ja, ka qenë: të finalizohet procesi i vonuar i kalimit të digjitalizimit, të lirohet dividendin digjital dhe të rishikohet plani kombëtar i brezit të gjerë dhe me objektiva të qarta. Këtu dua të sqaroj se RTSH-ja ka qenë dhe është në pararojë të procesit të digjitalizimit dhe puna e bërë në këtë drejtim, pavarësisht vështirësive të shumta financiare dhe të tjera, meriton vetëm fjalë të mira. Duke ndjekur strategjinë e përcaktuar të digjitalizimit, RTSH-ja ka qenë e gatshme për fikjen e transmetimeve analoge në *allotmentin* e Tiranës, që përfshin: Tiranën, Durrësin, Kavajën dhe Krujën, që në datën 1 dhjetor të vitit 2016 dhe është në pritje të vendimit për mbylljen e tij. Siç janë në dijeni edhe deputetët e nderuar këtu apo edhe opinioni publik, AMA ka ndryshuar disa herë strategjinë dhe datat, duke e filluar këtë proces në disa *allotmente* më periferike, siç janë Berati dhe Korça. RTSH-ja ka qenë e gatshme për të gjitha këto lëvizje dhe jo vetëm që ka mbuluar këto zona me sinjalet e programeve të veta, por ka qenë mbështetëse e transmetuesve privatë në të gjitha këto *allotmente*. Theksoj se mosfikja e transmetimeve analoge, sipas parashikimeve të paracaktuara në strategjinë e digjitalizimit, i ka sjellë një dëm të konsiderueshëm financiar Radiotelevizionit Shqiptar.

Pothuajse sot RTSH-ja e ka mbaruar plotësisht projektin e digjitalizimit, mbeten pa u ndezur vetën dy stacione, nga 60 të ndërtuara, dhe këto dyja janë vonuar jo për faj të RTSH-së, por për shkak të problematikave që lidhen me pronat ku do të vendosen këto stacione, probleme tashmë të zgjidhura. Kam kënaqësinë të them se të gjitha stacionet do të jenë “*on air*” në 3 muajt e ardhshëm.

Projekti i digjitalizimit ka nxjerrë problematika të shumta:

Së pari, paqëndrueshmëria e furnizimit me energji elektrike e stacioneve. Ky projekt është bërë pa depozita nafte. Gjatë vitit të kaluar RTSH-ja ndërtoi me fondet e saja 11 depozita nafte, të shoqëruara me sistemet e monitorimit dhe sigurisë kundër vjedhjeve dhe

shpërdorimeve. Këtë vit janë tenderuar dhe janë në proces ndërtimi të gjitha depozitat për të gjitha stacionet brenda kësaj vere, gjë që do të garantojë qëndrueshmëri të plotë të transmetimeve të RTSH-së në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Së dyti, projekti dhe kontrata e lidhur nuk garanton mbulimin 100% të popullsisë së Shqipërisë me sinjal televiziv. Në *allotmentet* ku është fikur sinjali analog, është vërtetuar se ka gropa dhe fshatra, të cilat nuk mbulohen me sinjal, siç është, për shembull, fshati Dardhë në Korçë apo zona e Gostivishtit apo Barmashit në Kolonjë, apo edhe zona të tjera. Matjet e plota do të bëhen kur të fiket i gjithë analogu dhe transmetimet të kalojnë në digjital, por megjithatë vetë projekti dhe kontrata parashikon që 3%-4% e popullsisë të ngelet pa sinjal tokësor.

RTSH-ja, duke pasur parasysh këtë, transformoi transmetimet satelitore, për të pasur tani transmetime me cilësi të lartë satelitore, ku kapen falas 6 kanalet e saj, duke garantuar sinjal për të gjithë, njëkohësisht duke e mbrojtur dhe mos shkelur të drejtat e transmetimeve televizive në Europë.

Së treti, vendet ku ne kemi sinjal zyrtarisht, por nuk kemi për popullin, siç janë disa zona në Berat apo në Lezhë. Kjo për shkak se antenat e RTSH-së janë në drejtim të kundërt me antenat e transmetuesve të tjerë privatë dhe bën që qytetari të detyrohet ta kthejë antenën herë andej dhe herë këtej, në qoftë se do t'i shikojë të gjitha kanalet. Për shembull, në Lezhë ku nga Instituti i Monumenteve të Kulturës nuk u lejua që RTSH-ja të ngrerë stacionin e saj aty ku janë të gjithë të tjerët dhe ku ishin planifikuar në projekt, në Tyrben e Lezhës, sepse është monument kulture, por njëkohësisht nuk u mor asnjë masë për të lëvizur antenat e transmetuesve privat nga ajo pikë dhe të vinim të gjithë në një pikë. Kështu që shikuesit tanë ndodhen në një situatë pak a shumë qesharake për këtë gjë. E njëjta situatë është edhe për *allotmentin* e Beratit dhe për disa zona në Durrës.

Dua të theksoj se, pavarësisht këtyre, RTSH-ja është në ballë të procesit të digjitalizimit dhe asnjë platformë tjetër apo televizion kombëtar nuk mund të krahasohet me të.

Gjithashtu, theksoj se 100% e investimeve të kryera në RTSH janë në funksion të këtij procesi, jo thjesht në fushën e transmetimeve që përmenda, por edhe në drejtim të prodhimit radioteleviziv. Nënvizoj një transformim gjigant të teknologjisë së prodhimit televiziv, e pamenduar qoftë edhe para një viti. I gjithë prodhimi televiziv i sotëm është i standardit që kërkon transmetimi digjital. Janë zëvendësuar të gjitha kamerat, mikserat, regjitet, kabllimet; është ngritur dhe një *datacentër* modern, sipas të gjitha parametrave të përparuar; ka filluar paralelisht digjitalizimi i Arkivit që kemi në *Beta*, sepse kemi vetëm ato pajisje, dhe po krijohen protokollet për digjitalizimin e arkivit të vjetër të filmit *Ampec* dhe *Bosch*, si dhe mënyrën e

arkivimit të prodhimit të ri. Është instaluar një sistem modern i menaxhimit të medias, si dhe ka filluar punë akademia e RTSH-së me trajnime të përditshme të stafit me sistemin e menaxhimit të aseteve mediatike, si dhe po punohet për kthimin në HD të studiove tona lëvizëse. Janë në përfundim automatizimi i proceseve për 4 kanale tematike dhe së shpejti fillon gjysmautomatizimi i proceseve për kanalin e parë të RTSH-së, në mënyrë që shumë shpejt të kalojmë në automatizimin e lajmeve. Kështu do të kalojmë në një ndryshim tërësor të mënyrë së të menduarit dhe të punuarit në RTSH.

RTSH-ja kërkon ndihmë dhe investime të tjera në këto drejtime që përmenda.

Të nderuar deputetë, ju ishit dëshmitarë të kërkesave dhe të përpjekjeve tona për të siguruar financimin e duhur për digjitalizimin e Arkivit apo për ruajtjen e Arkivit, për *network* –un dhe sistemin elektrik, përpjekje që, me gjithë përkrahjen tuaj të plotë, por edhe të deputetëve të Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, përsëri rezultuan të pasuksesshme dhe RTSH-ja nuk mori asnjë shtesë financimi. Përkundrazi, u ulën ndjeshëm të ardhurat nga tarifa e përdorimit të aparatit televiziv, mbeti i pandryshuar komisioni absurd prej 10% që merr OSHE-ja nga tarifa e aparatit. Nuk u zbatua ligji që për biznese të faturohet sipas aparateve televizivë që kanë dhe që rezultojnë në një situatë absurde, që edhe hoteli me 200 apo 300 dhoma dhe 300-400 televizione, të paguajë të njëjtën tarifë sa paguan një pensionist në një fshat të largët. Këto problem, me gjithë përpjekjet tona të mëdha, kanë ngelur pa zgjidhje.

Unë dua të nënvizoj edhe një situatë absurde, ku na futi Ministria e Financave për vitin 2018. Gjatë vitit të kaluar qeveria i dha RTSH-së 100 milionë lekë nga buxheti i shtetit, me qëllim krijimin e “RTSH Agro” që në kontratën e AMA-s shënohet “RTSH Jetë”, shumë e cila u tenderua për të blerë pjesë të pajisjeve të nevojshme, ku shuma e domosdoshme ishte 200 milionë lekë. Në fund të procesit të tenderimit, kur u lidh edhe kontrata me operatorin importues përkatës, Ministria e Financave e shkurtoi papritur fondin prej 100 –milionësh, duke e lënë RTSH-në sot me një borxh të tillë ndaj një importuesi privat dhe duke bërë të pamundur realizimin e projektit.

Sot RTSH-ja ka ndryshuar në të gjitha drejtimet, ashtu siç kanë dhënë efektin e tyre në transmetime dhe investime në teknologji, ashtu kanë dhënë efektin e tyre dhe zbatimin e parimeve editoriale në forcimin e pavarësisë dhe profesionalizmit nga gazetarët e RTSH-së.

Sot RTSH-ja merret si shembull në raportet ndërkombëtare dhe është radiotelevizioni më i përparuar në rajon në këtë drejtim. Konfirmimin për këtë e kemi marrë nga ballafaqimet dhe raportet ndërkombëtare, por, së pari, e kemi marrë nga shikuesit, të cilët e kanë rritur dukshëm interesin e tyre për të ndjekur programet tona. Pas një sërë sondazhesh, të kryera nëpërmjet telefonatave dhe sondazheve *online*, rezultojnë se është rritur ndjeshëm

shikueshmëria, duke e bërë RTSH-në tashmë jo një zgjidhje sporadike, por një zgjidhje të përhershme.

Për fat të keq, në Shqipëri nuk kemi kompani të specializuara për matjen e audiencës. Në një raport të fundit të Këshillit të Europës rezultoi se të gjitha të dhënat e deritanishme për matjen e audiencës kanë qenë fiktive dhe të pavërteta, raport, i cili vërtetoi pretendimet e Radiotelevizionit Shqiptar në këtë drejtim.

Ndryshimet në strukturën programore po ecin me shpejtësinë e teknologjisë. Prodhimi radioteleviziv është rritur jashtëzakonisht shumë, gjë që e bën të pamundur të renditësh gjithçka që është bërë, por dua të theksoj se janë strukturuar plotësisht 3 kanale gjeneraliste: RTSH 1, si kanali kryesor i saj, RTSH 2, që u drejtohet minoriteteve, shtresave në nevojë dhe shtresave të marginalizuara, traditave dhe risive nën sloganin “Të ndryshëm, por të barabartë”, janë prodhuar emisione të dedikuara për këtë kanal dhe është reduktuar ndjeshëm materiali arkivor. Emisionet, si: “Ditë të mbarë”, “Transkulturë”, “Me Bledin”, “Fletorja Zyrtare”, “Ne” e të tjerë i kanë dhënë larmi të madhe këtij kanali. Kanali pasurohet me kulturë dhe art nga vendi dhe vendet e rajonit me seriale dhe *sitkome* të dedikuara. Është strukturuar plotësisht kanali gjeneral RTSH 3, i dedikuar për shqiptarët jashtë atdheut nën sloganin “Të gjithë në një gjuhë”, ku ka prodhim të përditshëm nga diaspora, nga studioja e Tiranës, por edhe nga studiot e Torontos, Londrës, Nju Jorkut, Detroitit, Athinës e të tjerë. Ka filluar punën plotësisht kanali RTSH 24 me lajme dhe lidhje direkte, me transmetime maratonë të një cilësie të lartë dhe me komente në studio, dhe aty ku ndodhin ngjarjet, jo ashtu siç thotë raporti i AMA-s, që nuk kanë filluar ende transmetimet. Të mos flasim për kanalin e sportit, i cili po kthehet në një nga kanalet më të ndjekur dhe më të rëndësishëm në këtë fushë, që jep kontribut të madh në shërbim të publikut, duke filluar që nga pasqyrimi dhe nxitja e sportit në shkolla e deri te pasqyrimi dhe transmetimi *live* i sporteve si: volejboli, basketboli, atletika, mundja, ngritja e peshave, çiklizmi e deri te fluturimet e lira në hapësirë dhe jo duke mbetur vetëm te futboli dhe bastet.

Të gjitha kanalet që përmenda kanë zhvillime interesante, secila sipas karakteristikave me ngjyrat e veta dhe sloganet e veçanta. Kjo është bërë e mundur me ngritjen dhe forcimin e një sektori grafik, nga më të mirët në vend dhe sektorit të montazhit televiziv të mirëpajisur dhe mirëtrajnuar. Edhe sot që po flasim kemi inxhinierë ndriçimi, kameramanë dhe skenografë në trajnim në Turqi, ashtu siç kemi pasur teknikë, inxhinierë dhe regjisorë në RAI apo trajnime që kanë filluar të bëhen brenda RTSH-së, në atë që ne e quajmë akademia e RTSH-së.

Nuk dua të rri pa përmendur edhe punën që po bëhet në Radio Tirana në të gjitha kanalet e saj. Radio Tirana 1 ka rifilluar pas shumë e shumë vitesh prodhimin dhe transmetimin e radiodramave për të rritur e fëmijë. Ajo është e vetmja radio në vend që ka emisione të plota



dhe të larmishme për kulturën e gjuhën, politikën e ekonominë, jetën sociale e artin, për qytetin dhe fshatin, e cila bën dallim në tregun e transmetimeve radiofonike, e kundërta e radiove të tjera në vend, të cilat janë thjesht lista me muzikë angleze apo amerikane.

Radio Tirana 2 ka ndryshuar komplet strukturën programore, duke u bërë kanali i rinisë dhe i këngës shqipe, ku veçoj emisionin e përditshëm “Të rinjtë për të rinjtë”, i cili është me pjesëmarrjen e mbi 100 të rinjve, të cilët e drejtojnë vetë dhe trajtojnë problematika të rëndësishme.

Po kështu është ristrukturuar edhe Radio Tirana 3, që u drejtohet shqiptarëve jashtë atdheut. Duke mos harruar edhe radion e Jashtme, që transmeton në 7 gjuhë të huaja nëpërmjet internetit dhe faqes *online* për Radio Tirana International.

Gjatë këtij viti janë rritur kërkesat për bashkëpunim me RTSH-në, për organizimin e shumë eventeve në kryeqytet e më gjerë. Projektet që prezantohen pranë RTSH-së janë shtuar dhe po shqyrtohen nga një grup pune i dedikuar për projektet e ardhshme, i cili përkujdeset për të zgjedhur propozimet më cilësore.

Me propozim të drejtorisë së përgjithshme Këshilli Drejtues ka miratuar rregulloret e miratimit të projekteve dhe rregulloret e përdorimit të fondit të prodhimit të pavarur.

Më duhet të theksoj se në rrugën tonë të vitit të kaluar kemi pasur sektorë, ku gjërat nuk kanë ecur ashtu siç duhet. Njëri prej tyre është sektori i *web-it*, i cili ka mbetur siç ka qenë, i prapambetur dhe jo aktiv, gjë që ka ndihmuar edhe në mungesën e një transparence me publikun, ku nuk paraqitet puna e bërë, por edhe struktura organizative e drejtuesve të sektorëve, vendimet e Këshillit Drejtues dhe të Bordit të Administrimit, mbledhjet e Këshillit të Shikuesve, Dëgjuesve e të tjerë. Më duhet të raportoj para këtij komisioni se, ndërsa puna e Drejtorisë së Komunikimit nga analiza e bërë në Drejtorinë e Përgjithshme u trajtua si një dështim, Këshillit Drejtues iu propozua shkrirja plotësisht e Drejtorisë së Komunikimit dhe krijimi i sektorit të Promocionit dhe të *web-it* me një plan të detajuar për të rindërtuar që nga fillimi *web-in*, punën me rrjetet sociale, ndjekjen e mendimit të shikuesve dhe të dëgjuesve, si dhe transparencën e institucionit. Ky sektor i ri tashmë ka filluar punë dhe rezultatet do të shihen shumë shpejt. RTSH-ja nuk duhet të jetë pasive në promocion, ne do ta bëjmë *brendin* tonë të ndihet dhe do të tregojmë te shikuesi se si shpenzohet çdo qindarkë që mblidhet nga kontributi i tyre, sepse ky është një hap i rëndësishëm në forcimin e besimit publik ndaj RTSH-së.

RTSH-ja punon çdo ditë me të sotmen, por njëkohësisht ka hedhur edhe një këmbë të fuqishme tek e ardhmja. Një histori e plotë suksesi është platforma jonë e transmetimeve nëpërmjet internetit *over the top television*, që shtrihet në *mobile*, *smart tv* dhe *on demande*, që

është një hap gjigand si alternativë ndaj radiotelevizionit linear. Sot kjo platformë ka rreth 350 mijë përdorues në të gjithë botën dhe hap një perspektivë të shkëlqyer për bashkëbisedimin e ardhshëm të RTSH-së me shikuesit dhe dëgjuesit e vet.

Të nderuar zotërinj deputetë, unë ju kërkoj ndjesë për zgjatjen e fjalës, gjë që nuk e kam zakon, por në respekt të punës së bërë gjatë një viti, isha i detyruar t'i thosha.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Keni diçka për të shtuar?

**Pandi Madhi** - Drejtori i Përgjithshëm përmendi disa problematika që ka pasur gjatë vitit 2018, veçanërisht mosrealizimi i të ardhurave nga tarifa e përdorimit të aparateve televizive, që arrin një shumë të konsiderueshme, 120 milionë lekë; po kështu edhe nga shfrytëzimi i infrastrukturës transmetuese, 30 milionë lekë, të cilat mund të ishin reduktuar, por që nuk varen nga RTSH-ja. Kësaj shume, nga akti normativ që miratua në fund të vitit 2018, i shtohet edhe heqja e investimeve prej 100 milionë lekësh, e cili shtoi edhe më shumë problematikat. RTSH-ja e filloi vitin 2019 me një vlerë minus 100 milionë lekë. Kështu që edhe në buxhetin e këtij viti janë parashikuar treguesit financiarë, por që në 3-mujorin e parë shikohen mosrealizime, veçanërisht me realizimin e të ardhurave nga tarifa e përdorimit të aparatit televiziv, që arkëtohet nga OSHE-ja. Mosrealizimet e vitit të kaluar bënë që RTSH-ja të mos ishte në gjendje të paguante edhe një pjesë të kështit të kredisë, me një vlerë prej rreth 170 milionë lekësh, gjë që sipas marrëveshjes së bërë është paguar nga qeveria, konkretisht nga Ministria e Financave.

Nëse ka pyetje për pjesën financiare, jemi të gatshëm për çdo sqarim.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Fjalën e ka zoti Musa Ulqini, relatori, pastaj vazhdojmë me pyetjet dhe komentet.

**Musa Ulqini**- Faleminderit, zonja Milva!

Në fund të raportit të Shërbimit të Monitorimit është shtuar një paragraf, ku analizohen detyrimet e Këshillit Drejtues të RTSH-së lidhur me detyrat e vëna në rezolutën e miratuar nga Kuvendi, të cilat janë një mundësi e mirë që ne sot të kemi një debat thelbësor për RTSH-në, duke e parë punën e RTSH-së nga këndvështrimi i ligjvënësit dhe nga interesi i publikut.

Fjalën time e kam ndarë në tri pjesë.

Në pjesën e parë dua të ndalem te një gjë e re, e cila ndodh për herë të parë, sepse ne për herë të parë në dhjetor të vitit 2018 kemi miratuar një manual, ku kemi standardizuar se si duhet të paraqiten raportet nga institucionet e pavarura. Ky manual për monitorimin vjetor dhe periodik të institucioneve të pavarura, i cili është miratuar nga Kuvendi, u është bërë me dije

që në datën 7 janar të gjitha institucioneve dhe Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar. Në qoftë se e shikojmë raportin dhe e ballafaqojmë nga pikëpamja e paraqitjes së tij me kërkesat e këtij dokumenti, ka disa gjëra që duhen rregulluar. Raporti ndjek një traditë të formësuar prej disa vitesh për aktivitetin e tij 1-vjeçar, por Kuvendi ka vendosur që të ketë një mënyrë tjetër paraqitjeje dhe parashtrimi të problemeve.

Ju në fjalën tuaj kërkuat falje për diçka që unë nuk e kam kuptuar pse ndodhi, sepse RTSH-ja ka pasur traditë që raportet i ka sjellë në kohë dhe raporti ka pasur gjithmonë një analizë lidhur me realizimin e detyrave të vëna në rezolutën e miratuar nga Kuvendi, dhe nuk kishte asnjë arsye që në takimin me drejtuesit e institucioneve të pavarura Kryetari i Kuvendit vërejtjen e parë ta kishte për Këshillin Drejtues, por siç e tha edhe zoti Traja, kjo nuk është asgjë tjetër, veçse një gabim teknik ose neglizhencë, që nuk kishte arsye pse të ndodhte. Kështu që, shqetësimet, kritikën dhe vërejtjet lidhur me paraqitjen me vonesë të këtij raporti nuk kishin arsye pse të ndodhnin dhe të bëhej objekt diskutimi dhe kritikash të panevojshme, sepse raporti ka kohë që është miratuar, nuk është miratuar në datën 12, kur është paraqitur i plotë. Gjithashtu, edhe mungesa e analizës së rezolutës, që është në pjesën e shtojcës, nuk kishte pse të ndodhte, por unë nuk kam pse të ndalem përsëri te këto çështje, sepse gjërat u thanë dhe u kërkua ndjesë. Ne e pranojmë ndjesën dhe jemi të sigurt që gjërat do të ecin para, por përsëri këmbëngul që Këshilli Drejtues duhet medoemos të marrë në konsideratë dhe të analizojë se si duhet formatuar e gjithë mënyra e raportimit të institucionit tuaj në komision dhe në Kuvend, duke pasur parasysh këtë dokument të ri të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Për shembull, këtu kërkohet që pjesë e raportimit të jetë edhe ajo se çfarë thotë progresraporti dhe si është ecuria e punës në RTSH gjatë një viti, lidhur me detyrimet që lindin nga vërejtjet, kritikën apo sugjerimet që janë në progresraport. Kjo mungon te raporti vjetor dhe është e pakuptueshme, sepse ne kemi vlerësime shumë pozitive dhe, siç e tha edhe drejtori, në progresraport ka vlerësime pozitive për ecurinë e Radiotelevizionit, por është thjesht një neglizhencë.

Unë mendoj se vitin tjetër do të kemi respektim të mënyrës së re, jo të faqesjes së raportit, sepse kjo është një gjë formale, por të gjithë mënyrës së komunikimit të Këshillit Drejtues dhe kryetarit, zotit Kristaq Traja, me Kuvendin dhe institucionet.

Çështja tjetër, që vlen për t'u diskutuar, është që ne vëmë re se ka disa kontradikta, të cilat nuk duhet të ekzistojnë, se çfarë thuhet në raportin e AMA-s dhe çfarë thuhet në raportin e RTSH-së. Natyrisht që ka një kontratë shërbimesh, por ne, si komision, duhet ta bëjmë më mirë punën, sepse po të lexojmë raportet, dallohet se në disa gjëra jo të vogla ka diskordanca, që nuk janë të vërteta. Për shembull, në raport thuhet se nuk është hapur kanali dytë për fëmijë, e cila është një vërejtje që Shërbimi i Monitorimit e shënon dhe diskutohet në komision pse

nuk është realizuar, ose kanali “RTSH Jetë”, “RTSH Agro”, problemet e mungesës së pagesës së operatorëve lokalë nga AMA, apo çështjet e mbulimit të zonave. Ka diskordancë mes informacionit që ka raporti i AMA-s dhe informacionit që sillni ju këtu. Këto janë gjëra që krijojnë te deputetët dhe te Shërbimi i Monitorimit probleme të panevojshme, që ne duhet t’i zgjidhim.

Së treti, ne kemi një Shërbim të Monitorimi. Aty ka qenë një eksperte që e njihte mirë institucionin, çdo institucion ka specifikat e veta, sepse ti mund të jesh një jurist shumë i mirë, por duhet të njohësh edhe specifikat e institucionit, e kam fjalën për zonjën Sonila Kadare, e cila nuk është më këtu dhe kemi nevojë që të kemi një specialist, i cili aftësive të veta duhet t’u bashkëngjisë edhe një njohje sa më konkrete të specifikave të institucionit, në mënyrë që kur të bëhet monitorimi, të respektohen specifikat e institucionit.

Është bërë një punë shumë e mirë nga Shërbimi, por lexoj vërejtje se si duhet të ishin parimet editoriale. Për parimet editoriale të RTSH-së, që është i vetmi transmetues që i ka këto...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë e di që ai tekst ka edhe mënyrën se si funksionon, nuk ka vetëm parimet. Ai dokument ka edhe mënyrën se si këto parime jetësohen në aktivitetin e përditshëm të RTSH-së. Kjo është vërejtja. E di që është bërë me ekspertizë të gjerë nga EBU-ja, nga OSBE-ja dhe nga ekspertë shqiptarë, por nuk e di se sa është në kapacitetin apo në detyrimet e Shërbimit të Monitorimit të hyjë në këto çështje. Shërbimi i Monitorimit duhet të shohë të gjithë aktivitetin e institucionit të pavarur në përputhje me këto kërkesa, që, siç ju thashë, kishte disa mangësi, për të cilat u kërkua ndjesë.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Unë e paskam kuptuar gabim, që ka vërejtje për mënyrën se si është hartuar dokumenti, sepse unë mendoj që dokumenti është nga më të mirët në Shqipëri. E diskutojmë herë tjetër këtë çështje.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Dakord!

Shumica e gjërave u thanë, por ne jemi të detyruar t’i themi dhe t’i pohojmë fort, sepse transmetuesi publik është një pasuri e madhe publike e këtij vendi dhe ne duhet të themi se sot kemi cilësinë e sinjalit më të mirë në Republikë nga një transmetues televiziv; kemi një ofertë të re, e cila ka nevojë për përmirësim, por që është cilësore; kemi edhe një platformë të re me një numër të konsiderueshëm programesh, e cila ka bërë që të kemi një audiencë në rritje, por nuk kemi një institucion që ta masë tamam se sa është kjo rritje.

Fakti që numri i institucioneve që bashkëpunojnë me RTSH-në është rritur, është një tregues pozitiv për RTSH-në, sepse, kur RTSH-ja ishte një transmetues pa audiencë dhe pa cilësi, natyrisht që edhe numri i kërkesave për bashkëpunim ishte i vogël.

Një arritje tjetër është kanali i ri i lajmeve, “RTSH 24 orë”, që sjell cilësi të lartë transmetimi, por besoj që nga dita në ditë, sepse në qershor apo në maj është hapur, ai sjell një informacion cilësor për shikuesit. Mendoj se fytyra e re e 3 kanaleve të përgjithshme: RTSH 1, RTSH 2 dhe RTSH 3 për shkak të dizajnit apo grafikës është një arritje që ne duhet ta përmendim. Mendoj se RTSH-ja me kanalet e dedikuara po bën një revolucion. Ne kemi një kanal “RTSH Sport”, i cili jo thjesht me transmetimin e Kampionatit Botëror, por tek të gjitha programet e sportit, këtu kam një specialist që mund të flasë shumë mirë për këtë çështje, po sjell një risi në transmetimet televizive.

Unë dua të falënderoj publikisht drejtorin e RTSH-së që për herë të parë nuk pranoi të ndante paketën e transmetimit të Kampionatit Botëror me të tjerët, duke e transmetuar në mënyrë ekskluzive dhe kjo i dha një mundësi shumë të madhe RTSH-së që të njihej nga publiku i gjerë. Po kështu, dhe ndryshimet në teknologji dhe në përmbajtje. “RTSH Fëmijë” është një kanal, i cili nuk krahasohet me programet për fëmijë të kanaleve të tjera, të cilat i kanë të pakta, ndërsa ky është 24 orë. “RTSH Film” është platforma, besoj nga më të mirat, e filmit të huaj në Shqipëri. “RTSH Shqip” është një platformë që gjithmonë dhe më tepër po bëhet një platformë cilësore, që përhap kulturën shqiptare brenda dhe jashtë vendit dhe “RTSH Muzikë”, që përpiqet të kultivojë shije të mira për muzikën në vend.

Në këtë rast, nuk do rri pa përmendur edhe platformën “RTSH Tani”, sepse është një mundësi e madhe, që duke shfrytëzuar teknologjitë e reja, shqiptarët, qytetarët, publiku të kenë mundësi të ndjekin transmetuesin publik edhe përmes mjeteve të tilla, siç janë pajisjet në fjalë.

Një ndryshim kolosal është arritur te transmetimet satelitore, pasi ka qenë një kanal i vdekur. Tani kemi 6 kanale TV dhe 4 kanale Radio duke krijuar një mundësi të madhe, për shembull, shqiptarët nga Australia në takimin që u bë me diasporën, kishte disa shqiptarë nga Adelaide, që flisnin për transmetimet e RTSH-së në Kanada, në Amerikë, në Europë. Pra, është një mundësi e madhe për të bashkëbiseduar apo për të informuar shqiptarët jashtë atdheut. Studiot lokale po përmirësohen. Unë pata fatin të shikoja ndryshimet që janë bërë në Kukës, një ndryshim kolosal: nga disa studio lokale, që duheshin mbyllur, në gjykimin tim, tani po kthehen në një mundësi për të informuar ose për të zbatuar kërkesat e ligjit, i cili kërkon që të ketë informacion lokal nga studiot lokale.

Radio Tirana, siç u theksua këtu nga drejtori, ka një ndryshim të madh, por unë dua të theksoj se për herë të parë kemi Radio Tirana Internacionale që transmeton në 7 gjuhë, me një cilësi dhe teknologji të re; është një program që i mundëson Shqipërisë të transmetojë informacion të paanshëm për të gjithë publikun jashtë, i cili gjithnjë e më tepër ka interes për Shqipërinë.

Në fund, dua të them se në zbatim të Deklaratës së Qëllimit ne kemi programe të shumëllojshme; nuk ka asnjë transmetues që të ofrojë këtë mundësi siç është RTSH-ja. Kjo është detyrë e këtij transmetuesi, kemi programe edhe për fëmijë, edhe për moshën e tretë, për fermerët, për mësuesit, për shtëpiaket edhe për pakicat, siç u tha këtu.

Kemi informacion të paanshëm dhe gjithëpërfshirës, RTSH-ja është i vetmi transmetues në Ballkan ndaj të cilit nuk drejtohen protestuesit as për ta pushtuar dhe as për ta linçuar. Ky është një lajm i mirë, i bën nder RTSH-së, i bën nder edhe komisionit tonë. Në Beograd protestuesit, opozita, kishin target pushtimin e transmetuesit publik për shkak të mënyrës se si funksionon dhe si informon publikun; po kështu edhe në Malin e Zi, edhe në Maqedoni. Në Shqipëri nuk ekziston një gjë e tillë dhe ky është një tregues, një fakt kuptimplotë, që tregon ndryshimin e madh që ka ndodhur në RTSH në zbatim të Deklaratës së Qëllimit, për të dhënë informacion të paanshëm gjithëpërfshirës dhe objektiv.

Sot RTSH-ja ka një vlerësim të spikatur, që nuk ka qenë më përpara, edhe nga institucionet ndërkombëtare. Çfarë ka thënë OSBE-ja për zgjedhjet? RTSH-ja ka pasur vlerësimin më të madh në historinë e pluralizmit për paanësinë në mënyrën se si i ka pasqyruar zgjedhjet e vitit 2017; është progresraporti i BE-së i vitit të kaluar.

Një arritje shumë e madhe, që nuk u tha, por duhet të theksohet, për herë të parë në Shqipëri u mbajt Asambleja e 80 e EBU-së, që është institucioni më prestigjiozi që bashkon të gjithë transmetuesit publikë: janë 76 transmetues nga 56 vende, janë 2000 radio dhe televizione. Nuk u bë mbledhja këtu për shkak të germave të alfabetit të Shqipërisë, por u bë këtu, sepse u vlerësua nga drejtuesit e institucionit: “Një transmetues i një vendi të vogël, që po bën përpjekje të mëdha, për të pasur ndryshime në teknologji, në strukturë, në programacion dhe në informacion”.

Radiotelevizioni ka shumë sfida. Ajo kryesorja është që më 1 shtator, siç është vendosur nga AMA, të paktën në pellgun Tiranë-Durrës të jenë transmetime digjitale. RTSH-ja ka qenë gati prej kohësh. Besoj se, ashtu siç u tha këtu, ajo nuk ka probleme, por përkundrazi, për shkak të mënyrës se si është informuar publiku nga institucionet e tjera, ky afat është ndryshuar disa herë dhe ndryshimi i këtij afati është me kosto të lartë për RTSH-në, sepse kjo e fundit është detyruar që pasi ka bërë investimin, të transmetojë edhe në analogë,

që është kosto shumë e madhe, pra që të mbajë dy platforma paralele. Unë besoj se në këtë pikë RTSH-ja e ka zgjidhur këtë sfidë, kjo është një sfidë e madhe. Besoj se nuk do të kemi probleme nga RTSH-ja, por ato mund të jenë nga të tjerët.

Një sfidë tjetër është çështja e të ardhurave dhe taksa e aparatit. Ne kemi një detyrë, si komision, të bëjmë çfarë është e mundur që ai 10%-shi, që më duket pakuptim, të jetë ndoshta jo 2%, sa thotë RTSH-ja, por 1% ose 3%. Ne duhet që shqetësimin, sfidën e RTSH-së ta përballojmë së bashku. E kam fjalën edhe për raportin për taksën që paguajnë bizneset, por edhe për sasinë e parave që ndalet për çdo tarifë të aparatit.

Çështja e rrjetit të dytë, operatorët që transmetojnë atje. Ata thonë se RTSH-ja ka tarifa të larta, kjo e fundit thotë se i ka të ulëta. AMA nuk bën pagesën që e ka detyrim ligjor ndaj operatorëve lokalë. Kjo është një çështje që duhet të zgjidhet. Mund të zhvillojmë një takim. Nuk mund ta lëmë këtë çështje peng. Është bërë një takim, por operatorët lokalë ankohen, disa gjëra i kanë të sakta, por disa të tjera të pasakta. AMA ka vërejtjet e saj, RTSH-ja ka të sajat, kjo është një gjë, të cilën ne duhet ta kapërcejmë.

Ju kërkoj ndjesë për këtë që do të them tani, por si deputet i zgjedhur në një zonë rurale, siç është zona e Belshit, mendoj se sfida e RTSH-së për të pasur një program “RTSH Agro” është një gjë që i kalon kufijtë e shqetësimit, është një program që i drejtohet një audience shumë të madhe. Mendoj se ne duhet të këmbëngulim, të bëjmë presion ndaj qeverisë, duke i shpjeguar shumë mirë gjërat se si ngeli në mes kjo gjë, por duhet patjetër ta vlerësojmë këtë çështje, sepse RTSH-ja, për shkak të traditës, por edhe për arsye të tjera, ka një audiencë shumë të spikatur në zonat rurale. RTSH-ja duhet ta zgjidhë këtë çështje. Ne duhet të kontribuojmë për këtë gjë.

Në fund fare, për të relaksuar diskutimin tim, shpresoj dhe kam të drejtë të bëhem zëdhënës edhe i publikut, që RTSH-ja duhet ta ketë shumë shpejt edhe estradën e saj, kur them estradën, programet me humor, për shkak të fuqisë, të cilësisë, të shtrirjes, për shkak të popullsisë që mbulon dhe për shkak të detyrimeve që rrjedhin nga Deklarata e Qëllimit, sepse RTSH-ja informon, edukon, por edhe argëton, prandaj duhet që traditën më të mirë të dikurshme, që i përket një kohe tjetër, por tashmë në një kohë të re, RTSH-ja duhet që edhe në këtë pikë, e di shumë mirë që drejtori i RTSH-së do të thotë : “Zoti Ulqini, humor i kërkon para dhe pa para nuk ka as humor”, pra, besoj se ka ardhur koha të hidhen...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Jo, për para nuk ka humor. RTSH-ja ka nevojë për 1000 gjëra, sepse teknologjitë e reja kërkojnë shumë para.

E kam thënë edhe para 3 vjetëve, e vazhdoj të jem shumë kritik në raport me mënyrën se si qeveria jonë socialiste dhe qeveria që ishte më përpara, ajo e koalicionit, e ka parë këtë çështje, dhe ky ka qenë qëndrimi im në raport me atë gjë që thuhet në mënyrë precize në ligj, se ndryshimet rrënjësore, ndryshimet e mëdha teknologjike, janë çështje të buxhetit të shtetit; kështu e kanë të gjitha ligjet që rregullojnë transmetuesin publik. Kjo është një çështje, në këtë pikë, ku ndryshe nga komisioni dhe nga shumë të tjerë, vazhdoj të jem kritik dhe besoj se qeveria, Ministria e Financave, këtë pasuri kombëtare duhet ta shikojnë; kërkesat e RTSH-së për investime duhet t'i shikojnë në raport me ligjin. Kjo nuk është një gjë e sanksionuar në ligj nga ligjvënësi shqiptar, por është një gjë që nuk ka ndryshuar, edhe pse ligji është ndryshuar kaq herë, sepse është një standard se si funksionojnë transmetuesit publikë. Investimet në teknologji janë detyrim i buxhetit të shtetit. Investimet e tjera, siç është ajo për humorin apo programacionet e të tjera, lidhen me taksën, me reklamën me mënyrën se si RTSH-ja jo vetëm prodhon gjëra të bukura, informacione e të tjera, por krijon edhe të ardhura për vete me mjetet dhe me aftësinë që ka, për të qenë e pranishme në mjedis.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi**- Faleminderit!

Kush ka pyetje për raportin? A mund të hapim diskutimin?

Po, zonja Kumbaro.

**Mirela Kumbaro** - Faleminderit!

Dua të përshëndes të tre zotërinjtë e nderuar dhe t'i shpreh një mirënjohje të drejtpërdrejtë drejtorit, zotit Gëllçi! Në njëfarë mënyre, jo vetëm nga pozita, nga detyra publike që kam mbajtur dhe vazhdoj të mbaj, por edhe si një qytetare shqiptare mbetem një besnike e pakushtëzuar e RTSH-së dhe e kam ndjekur me interes profesional. Ndërkohë, duhet t'ia njohim meritën e drejtimit të RTSH-së zotit Gëllçi, për ta thënë më troç se në çfarë derexheje e mori dhe çfarë progresi është bërë.

Nuk do të hyj në detaje, sepse raportimi që bëri zoti Ulqini ishte shumë i detajuar. Bashkohem me zotin Ulqini dhe do të doja që kjo të ishte pjesë, në fakt, edhe e raportit të AMA-s, por nuk është. RTSH-ja duhet të ketë mbështetjen financiare nga buxheti i shtetit në një masë shumë më të lartë nga sa e ka dhe nuk mund të trajtohet njëllëj si kanalet e tjera kombëtare private, të cilat kanë një liri që RTSH-ja nuk e ka.

Në dëgjuesën e fundit, kur kishim përfaqësuesit e AMA-s, unë bëra vërejtjen për sa u përket programeve me karakter edukativ dhe kulturor. Nuk dua ta mohoj, nuk më erdhi mirë nga përgjigja që mora: “Kjo është detyrë më së shumti e RTSH-së”. Unë besoj se kjo është shumë e qartë në ligj, është detyrë e të gjitha medieve. Por duke dhënë këtë përgjigje që mua



nuk më pëlqeu, ata në të njëjtën kohë nxorën në pah atë që unë mendoj: RTSH-ja meriton një mirënjohje për faktin se është kanali që ka numrin më të madh të programeve kulturore, të cilat, e theksoj, nuk janë luks, janë domosdoshmëri ekzistenciale për publikun dhe për opinionin publik Shqiptar, që mbytet nga një keqinformim, lajme të rreme, e cila është një garë shumë e vështirë për t'u përballuar në kohën e teknologjisë dhe të rrjeteve sociale. RTSH-ja vazhdon ta bëjë me një kosto për të cilën jam shumë e ndërgjegjshme. Është e vetmja që mban programe elitare, 3-4 të tilla brenda javës, që i kushtojnë një kohë të veçantë edhe produktit, që konsiderohet më elitare, por do të duhet të luftojmë për ta bërë popullor, që është libri.

Përveç komplimentit dhe mirënjohjes që shpreh për ruajtjen e cilësisë, jo vetëm në televizion, por edhe në radio, të programeve me karakter kulturor, do t'ju sugjeroja se duke qenë se produksioni bëhet njëherë në radio dhe njëherë tjetër bëhet në televizion, nëse mund të shikohet mundësia të ketë një ndërkëmbim të tyre, për të ripërdorur përmes imazhit edhe ato programe që janë radiofonike, duke u bërë më shumë publicitet programeve radiofonike që shqiptarët, të cilët janë gjithë kohës nëpër makina, me kufje në vesh, të gjejnë më shumë arsye për të ndjekur programe shumë të mira të RTSH-së.

Një falënderim i veçantë personal shkon për një kanal shumë të mirë, që është "RTSH Klasik", që ka një muzikë shumë cilësore, e cila do të duhet të propagandohet shumë më tepër nga të gjithë ne dhe nga të gjithë ju, sepse është jo vetëm cilësore, por edhe shumë edukative.

Duke e mbyllur këtë pjesë, më takon të jap një përgjigje për diçka që zoti Gëllçi tha në raportin e tij, nga pozita e ish -ministres së Kulturës dhe të ndaj me ju informacion lidhur me vështirësinë që hasin jo vetëm RTSH-ja, por të gjithë operatorët televizivë dhe operatorët e telefonisë, të cilët kërkojnë të instalojnë antenat e tyre në pikat e larta në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Po bëj një histori të vogël, për fat të keq ajo që ka ndodhur deri në vitin 2013 është se vendosja e antenave në pozicione të ndryshme të larta, të cilat shumë herë përkojnë me pozicione të trashëgimisë kulturore, sepse në pikat më të larta ndodhen edhe kalatë, shpeshherë ndodhen manastire, rrënoja arkeologjike, këto antena deri në vitin 2013 janë vendosur pa leje të Këshillit Kombëtar të Restaurimeve apo Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, që është detyrim ligjor. Jemi përpjekur dhe e kemi disiplinuar këtë gjë në dy mënyra, në të njëjtën kohë duke mos lejuar instalimin e antenave të reja në këto pozicione në kala, të cilat kanë sjellë dëme. Të paktën unë e lashë në këtë pikë dhe jam e bindur se Ministria

e Kulturës dhe Instituti i Monumenteve vazhdojnë në një përpjekje dhe në një komunikim të vazhdueshëm me të gjithë operatorët për t'i hequr. Një pjesë janë hequr, një pjesë e mirë.

E kuptoj që mund të mos e dini, zoti Gëllçi, por dua t'ju konfirmoj se një pjesë e mirë janë hequr dhe për një pjesë tjetër Ministria e Kulturës është në procese gjyqësore, për t'i zgjidhur, sepse heqja kërkon zhvendosjen, ose nuk kemi miratuar për disa operatorë vendosjen e antenave të reja, pa lëvizur dhe pa respektuar kërkesat. Është një betejë të cilën Ministria e Kulturës ka 5 vjet që e zhvillon. Nëse janë bërë gabime dhe nëse jemi në luftë për t'i zhvendosur dhe për të gjetur pika të tjera në bashkëpunim me ne, kjo nuk duhet të thotë që të miratojmë vendosjen e antenave të reja atje ku ka kala apo trashëgimi kulturore.

Besoj se me një bashkëpunim, sikurse ka ndodhur shumë herë edhe për ndërhyrje të tjera për nevoja antenash apo dhe për transformime të vetë godinës së RTSH-së, të gjendet bashkëpunimi. Nëse ndihma ime do të ishte e nevojshme, jam shumë e lumtur dhe e gatshme ta bëj këtë në çdo moment, edhe nga ky pozicion që kam sot.

**Milva Ekonomi** - Para se t'ia jap fjalën kolegut, drejtorja e Shërbimit të Monitorimit të Inistitucioneve të Pavarura, kërkon të sqarohet pak.

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

**Alkida Llakaj** – Të nderuar,

Zoti kryetar i Këshillit Drejtues të RTSH-së,

Zoti Drejtor i RTSH-së!

Të nderuar deputetë,

Në emër të Shërbimit të Monitorimit, një shërbim brenda Kuvendit të Shqipërisë, më duhet të prenoncohem të paktën për pjesën në të cilën u përmend Shërbimi i Monitorimit.

Ne i shikojmë me një qasje tejet pozitive realizimet tuaja, por Monitorimi ka si parim kryesor të evidentojë problematika, me qëllim përmirësimin në të ardhmen. Pjesën e arritjeve ju takon juve ta prezantoni në komision, ndërsa neve na takon pjesa që evidentojmë problemikat.

Kryqëzimin e informacionit të paraqitur nga AMA dhe KDRTSH-ja ne thjesht e konstatojmë, është komisioni, i cili e vlerëson dhe merr vendime.

Për sa i përket këshilltarit, që e ka ndjekur deri më sot Këshillin Drejtues të Radiotelevizionit, nuk mund ta zgjedhë komisioni këshilltarin, ashtu sikundër as shërbimi e as pala që vjen të raportojë nuk zgjedh relatorin.

Në këto kushte, unë e mbroj me shumë vendosmëri cilësinë, paanshmërinë dhe objektivitetin e punës së Shërbimit të Monitorimit, duke u bazuar në Rregulloren e Kuvendit dhe në ato përcaktime ligjore që na jep si veprimtari shërbimi brenda Kuvendit të Shqipërisë.

Ju faleminderit!

**Musa Ulqini** – Unë nuk e kuptova, dhe është hera e parë që nuk e kuptoj, tash kaq shumë vjet që jam si relator i RTSH-së. Nuk ishte në fjalën time, por as nuk e çoj nëpër mend si deputet, i ri apo i vjetër, që të kërkoj të përcaktoj se kush duhet të jetë drejtor i zyrës së Shërbimit të Monitorimit apo njeriu që merret me këtë punë. Kjo s'ka lidhje.

Unë si deputet i këtij komisioni dhe si relator, ju garantoj se kam aftësinë profesionale të bëj dallimin mes raporteve që janë paraqitur nga zyra vit pas viti, sepse kam kaq vjet që merrem me këtë çështje.

Unë po them se bëra një sugjerim: që eksperti ose specialisti që do të mbulojë RTSH-në ka nevojë të konsultohet, gjithmonë nga pikëpamja ligjore, në mënyrë specifike me veçantinë që ka puna e RTSH-së.

Unë, që kam qenë hartues i ligjit të parë të RTSH-së, ju garantoj se dje kam lexuar edhe një herë disa nene të këtij ligji. Pse? Duhet të konsultohesh me të, sepse është ligj shumë i madh e me kaq shumë nene. Po kështu është edhe statuti, po kështu janë edhe dokumentet e tjera. Kësisoj, është e nevojshme të kemi dikë, i cili të mos ndërrohet. Pra, të caktohet sot dhe të jetë për një kohë të gjatë. Ky është sugjerimi im. S'kishte asgjë tjetër. Nuk mora përsipër të kërkoja ta caktonte as zoti Ruçi, as sekretari i Përgjithshëm, as drejtoresha se kush do të ishte. Kjo nuk është në tagrin tim e as nuk e mendoj një gjë të tillë. S'ka shans që ta mendoj një gjë të tillë. Unë thjesht bëra një sugjerim, që të kemi dikë, i cili të mos ndryshojë e të mbulojë edhe AMA-n, edhe RTSH-në. Ky është sugjerim. Mund të jenë dy. Shumë mirë, sepse specializohen njëri për detyrimet e AMA-s dhe tjetri për detyrimet e RTSH-së.

Kjo ishte. Nuk ka fare nevojë për keqkuptime. Ndërkohë, unë kam shumë dëshirë që drejtoreshës së re, të cilën e takova për herë të parë këtu, t'i uroj shumë suksese. Ne kemi nevojë të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, kemi nevojë të jemi në krah të njëri-tjetrit, sepse vetëm kështu gjërat bëhen mirë, duke respektuar secili mandatin e vet, secili detyrën e vet.

Unë shpresoj se ashtu siç ka ndodhur deri më tani, ne i kemi të gjitha shanset që me drejtuesin, me drejtoreshën e re, me njerëzit që punojnë atje, ne, të gjithë bashkë, të prodhojmë gjëra shumë të mira, të cilat do të jenë në funksion të përmirësimit të punës. Kaq!

**Milva Ekonomi** – Faleminderit për sqarimin, zoti Ulqini!

Unë kam përshtypjen se kjo gjë u sqarua. Edhe duke qenë se disa prej nesh janë për herë të parë anëtarë të këtij komisioni, pavarësisht se kanë kaluar disa muaj, e kuptojmë se Shërbimi i Monitorimit është në ndihmë të komisionit; e kuptojmë se kur janë rezolutat e institucioneve të pavarura, për të cilat ne jemi përgjegjës, Shërbimi i Monitorimit na ndihmon përherë për të kuptuar ecurinë, mbi bazën e strukturës ligjore e të kornizës ligjore që rregullon

veprimtarinë. Gjithashtu, është një moment kur kërkesa ndaj institucioneve të pavarura nga Kryetari i Kuvendit është bërë pak më precize. Kjo është formuluar më mirë javën e shkuar, kur me shumë ngulm u kërkuar të kihen parasysh dy gjëra: e para, se si institucionet e pavarura përmbushin detyrimet që vijnë nga Bashkimi Europian lidhur me *acquis communautaire* dhe me detyrimet që lë progresraporti; e dyta, raportimi për eficiencën e çdo institucioni, brenda fushës së vet të veprimit. Ishte rasti i Radiotelevizionit Shqiptar, në mbledhjen që organizoi zoti Ruçi, që efienca duhet të bëhet, gjithashtu, transparente. Kjo është një nga thirrjet që është bërë, ndoshta, për një arsye mbase shumë banale, për një organizim forcash brenda jush, që nuk ka ndodhur, edhe pse e keni vazhdimisht në mendje: që efienca e institucionit duhet të pasqyrohet gjithmonë në *Web*. Ne duhet të shikojmë se si e keni programin financiar gjatshëmujor, planin e biznesit, si e realizoni atë dhe çfarë ndodh me rastet kur keni ankesa apo kërkesa të tjera nga përdoruesit.

Këto gjëra i keni parasysh dhe kam përshtypjen se tani edhe Shërbimi i Monitorimit i di, i ka të qarta. Natyrisht, ne do të bëjmë një diskutim të brendshëm për të kuptuar ecurinë e ndjekjes së informacionit për dy institucionet që varen nga komisioni ynë. Besoj se tashmë këto gjëra janë sqaruar. Është një strukturë e re raportimi, ndaj është normale të ndodhin këto gjëra.

Ndërkohë, unë dua t'ju garantoj diçka tjetër: sa herë që ne kemi relator zotin Ulqini, ajo që na ndodh është se të gjithë ne, që jemi anëtarë të komisionit, marrim njohuri më të thella për fushën, sepse zoti Ulqini, duke qenë një deputet me shumë eksperiencë, arrin të na vërë në dukje jo vetëm bazën ligjore ku e mbështet vlerësimin e tij, por edhe ecurinë disavjeçare të zgjidhjes apo të moszgjidhjes së problemit. Kësisoj, unë nuk kam asnjë pikë dyshimi te puna që ka bërë zoti Ulqini për të qenë relator i raportit tuaj për veprimtarinë e vitit 2018, si dhe te dëshira e mirë që ai ka gjithmonë për ta bërë me dije komisionin dhe publikun lidhur me veprimtarinë e institucionit apo për çështje të tjera që ai relaton.

Me këtë rast, dua të theksoj edhe diçka tjetër: nëse ka një njeri që zbaton më mirë nga të gjithë Rregulloren e veprimtarisë së Kuvendit, e veçanërisht atë të komisionit, ai është zoti Ulqini, i cili referohet nen për nen dhe sipas momentit historik.

Kështu, zoti Ulqini, ne nuk e vëmë fare në dyshim dëshirën e mirë që ju kishit në lidhje me vazhdimin e punës së Shërbimit të Monitorimit me cilësi dhe në mbështetje të punës së komisionit tonë.

Ismet, fjala është për ty. Do të lutesha që ato shumë pyetje, t'i përmbledhësh në kohën që duhet.

**Ismet Beqiraj** – Epo mirë, s'po flas fare!

**Milva Ekonomi** – Me informacionin që ti ke, si pedagog i mësuar prej kaq kohësh me një lëndë të vështirë, natyrisht që di ta bësh përmbledhjen shumë mirë.

**Ismet Beqiraj** – Unë do ta filloj kështu, sepse edhe Bujari po më thoshte: përshëndeti, falënderoji! Unë, jo thjesht e vetëm si deputet, por edhe si qytetar i këtij vendi, rri disa minuta duke kërkuar kanalet e pëlqyera të RTSH-së, kur, që të jemi koshientë, jo shumë larg, por para dy-tre vjetësh, njerëzit kishin një ide, që RTSH-ja pothuajse nuk ekziston fare.

Kur i shikon dhe i prek gjërat, dhe ne si komision kemi pasur fatin edhe më përpara, por edhe gjatë këtij viti, që kemi qenë për vizitë në RTSH, ku e kemi parë realitetin me sytë tanë, si komision, të themi të vërtetën gjysma e institucionit ishte si spital lufte, ndërsa gjysma ishte një teknologji në ngjizje e në rritje, sigurisht, i respektoj të gjitha sugjerimet e vërejtjet, edhe ato të raportit të monitorimit.

Zoti Traja, populli thotë: “Koka e falur nuk pritët”. Diskutimi është i tepërt. Sot ne po diskutojmë në këtë komision dhe mua më vjen mirë që edhe në raportin e Monitorimit, por edhe në raportet e paraqitura, kryesisht në raportin e zotit Gëllçi, është një lajm i mirë për të gjithë shqiptarët dhe ndjekësit e shumtë të RTSH-së, që pothuajse pjesa dërrmuese e popullsisë, pra 97 % e saj, i shikon transmetimet me teknologji digjitale.

Ky është një lajm shumë i mirë. I thonë 97 %, jo pak. Pra, është një hop jo vetëm sasior, por edhe cilësor. Në këtë kontekst, edhe në raportin që paraqiti drejtori i Përgjithshëm, thuhet se kemi një hap cilësor në lidhje me transmetimin numerik.

Unë do ta thjeshtoja: në terma sasiorë, zoti Gëllçi, edhe sa për qind kanë mbetur? E di se është nga fundi, por edhe sa për qind ka mbetur për të gjithë territorin?

E dyta, edhe si koment, por edhe si pyetje: përsëri është një lajm i mirë, në lidhje me të cilin është për t’u falënderuar e vlerësuar stafi dhe institucionet që planifikojnë, orientojnë dhe drejtojnë këtë institucion, që nga Këshilli Drejtues, por edhe juve: a ka filluar edhe digjitalizimi i Arkivit dhe i aseteve të RTSH-së?

Në lidhje me këtë na intereson të dimë, për hir të së vërtetës: sa për qind e këtyre aseteve është digjitalizuar dhe sa kërkoni, edhe si ndihmesë, për ta zgjidhur këtë? Sepse ju nuk mund t’i zgjidhni problematikat vetëm, prandaj është edhe kontrolli parlamentar e, tek e fundit, dhe ky komision.

Një tjetër shqetësim, që më tërhoqi vëmendjen, lidhet me antenat, të cilat, kuptohet, vendosen në terrene të vështira, dominuese gjeografikisht, dhe kërkojnë siguri për transmetim non stop në aspektet e burimit energjetik. Në projektet e bashkëpunimit, tashmë edhe në perspektivë, a keni menduar ndonjëherë për zëvendësimin e lëndëve djegëse, karburanteve,

qoftë edhe pjesërisht, me energjisë solare, me energji të rinovueshme, me qëllim rritjen e pavarësisë edhe në aspektin ekonomik?

Më tërhoqi vëmendjen edhe një analizë në aspektin financiar. Gjatë vitit 2018 ka një mosrealizim të të ardhurave prej 5 %. Këtu, në këtë mosrealizim, pjesën e luanit e zë tarifa e aparatit televiziv. Duke e krahasuar me vitet 2016, 2017 e 2018, trendi i kësaj tarife është në rënie. Përse ka ndodhur kjo?

Përsëri, nga të ardhurat e shitjes së produkteve që prodhon vetë RTSH-ja, ku qëndron arsyeja që, në raport me të gjitha të ardhurat, ato janë pothuajse minore? Janë 41 milionë lekë. Gjithnjë lidhur me anën financiare, më shqetëson edhe një gjë tjetër. Ju thoni me të drejtë se na u hoqën kaq milionë me një vendim të veçantë, nuk e kemi realizuar këtë, por ama ka të ardhura të trashëguara nga njëri vit në tjetrin. Në 2016-ën janë trashëguar 260 milionë lekë të reja, gati 2, 5 miliardë lekë të vjetra; në 2017-ën janë trashëguar nga 2018-ta akoma më shumë: 288 milionë lekë të reja. Po ashtu, edhe këtë vit, që ishit pothuajse të pakënaqur edhe me buxhetin, edhe me të ardhurat, janë trashëguar 125 milionë lekë të reja. Përse nuk janë investuar këto? Sepse lekët kanë qenë. Si çdo specialist i financës dhe i statistikës, kur e shikon këtë, me të drejtë e bëj edhe unë këtë pyetje, meqenëse jam marrë me buxhete ekonomiko-financiare.

Në fund kam një kërkesë, si anëtar i komisionit, gjë për të cilën mendoj se jemi të gjithë në një mendje: u bë shumë mirë, e u rrit edhe autoriteti, kur mori ekskluzivitetin e transmetimit të Kampionatit Botëror. Kur do të filloni ta keni edhe monopolin e transmetimit të *Champions League*? Sepse, ashtu siç janë të varfra institucionet, po ashtu është e varfër edhe kuleta e shqiptarëve. Jo të gjithë e kanë mundësinë t'i marrin paketat. Ky shërbim mbështet një brez social të shoqërisë. Juve mund ta shisni këtë produkt edhe te operatorë të tjerë.

**Milva Ekonomi** – Të bëj edhe unë dy pyetje, që ta kalojmë pjesën e pyetjeve.

Në fakt, zoti Gëllçi, kur bëtë shpjegimin, ju thatë se kishit bërë një sondazh për të parë kënaqësinë e publikut. Pyetja ime, që lidhet edhe me një kërkesë të ardhur nga monitorimi i projektit që ju keni me Bashkimin Europian dhe OSBE-në, është: a ka menduar RTSH-ja për një strukturë permanente të matjes së kënaqësisë së publikut? A mendoni se kjo duhet të jetë diçka permanente, që nuk i shërben në vetvete daljes në publik me këto të dhëna, por i shërben menaxhimit më të mirë të punës programore që bën RTSH-ja? Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë është: nga diskutimet që bëri zoti Madhi, kuptova se një pjesë e kredisë, ngaqë ju nuk kishit para, u shlye nga shteti. Në fakt, diferenca midis agros dhe kredisë ngelej te shuma 70 milionë lekë, kështu që mbase...

*(Ndërhyrje pa mikrofon.)*

Po, pra, e kuptoj, se 170 minus 100 mbeten 70. Në fakt, nisur nga kjo që ju thatë, por edhe nga diskutimi i zotit Ulqini, që mendon se programet me karakter bujqësor janë të domosdoshme për pjesën më të madhe të popullatës, duke pasur parasysh se ju keni shtrirje shumë të gjerë, sidomos në zonën suburbane e rurale, a mundet Këshilli Drejtues ta marrë në konsideratë këtë pjesë të riprogramimit për një çështje që lidhet me bujqësinë?

Këto ishin pyetjet e mia!

**Thoma Gëllçi** – Faleminderit të gjithë deputetëve!

Pyetja e parë ishte: sa për qind e digjitalizimit ka mbetur?

Unë e theksova në fjalën time, që na kanë mbetur vetëm dy stacione: një stacion i Milesë, në Sarandë, megjithëse Saranda mbulohet me sinjal nga stacioni i Shën Vasilit dhe Ksamili, ndonëse Mileja, që është stacioni kryesor, është gati për t'u ndezur. Mund të nisë nesër, pasnesër, pra, është çështje ditësh. Stacioni tjetër është jo shumë i domosdoshëm për Krujën dhe kemi vendosur ta transferojmë e ta çojmë në Durrës. Kjo me qëllim që ta vëmë aty, ku i kanë edhe televizionet e tjera, që njerëzit të mos e kthejnë antenën lart e poshtë, sepse s'mund t'i bësh ta kthejnë antenën nga ana tjetër, kur duan të shohin RTSH-në.

Kështu, brenda tre muajve përfundon i gjithë projekti. Pastaj do të ketë punë me matjet, me një kompani të huaj, të specializuar. Ne, nga ana jonë, por edhe AMA, nga ana e saj, do të bëjmë matjet, nëse e ka realizuar kompania kontraktuese kontratën deri në atë masë, sa të ketë vërtet mbulim të popullsisë me sinjal televiziv në masën 97 %. Në qoftë se nuk e ka këtë mbulim, ata do të jenë të detyruar të bëjnë investime shtesë për ta mbuluar. Megjithatë, këto matje nuk mund të bëhen dot pa u fikur analogu. Duhet të fiket analogu, që të bëhen matjet.

Ne e kemi filluar digjitalizimin e Arkivit vetëm në *beta*. Kemi mundur të riparojmë katër aparate *beta*, dhe po fillojmë të punojmë me ato të katërta njëzet e katër orë. Kuptohet, procesi i digjitalizimit të Arkivit do të jetë i gjatë. Unë parashikoj se digjitalizimi i Arkivit të vjetër do të vazhdojë rreth dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet, në qoftë se do të fillojmë në *full scale*, domethënë të blejmë skanera, të blejmë pajisjet *Ampex* ose pajisjet *Bosch*, të cilat janë një pjesë e mirë e arkivit tonë.

Ne tashmë kemi bërë një projekt, kemi marrë përvojë sllovene, kemi marrë konsulentë sllovenë, ka ecur mire. Televizioni i Sllovenisë, po na shkruan një libër, që do të na tregojë se cilat janë hapat që duhet të ndjekim ne realisht, që të mos ecim në rrugë të pashkelura.

Kuptohet se procesi i digjitalizimit të arkivit do të kërkojë para, por do të kërkojë edhe kohë. Ajo që është e rëndësishme dhe duhet theksuar është se ne kemi vendosur një sistem modern arkivimi të produktit të ri.

Të mos kemi iluzione që digjitalizimi do të bëhet për një vit apo dy vjet. Digjitalizimi do të jetë një proces gati 15- vjeçar apo më tepër, se është gjithë ai material, që aq orë sa kohë ka aty, aq kohë fizike do që të digjitalizohet filmi etj., etj.

A kemi menduar ne për të zëvendësuar depozitat e naftës dhe energjinë elektrike me energji diellore? Sigurisht që ne kemi menduar dhe kemi pyetur, dhe na rezulton se është pothuajse e pamundur që të bëhet kjo, sepse në maja malesh nuk ka territore. Ne kemi një territor të kufizuar të vendosjes së antenave, vende për të cilat paguajmë qira, në shumicën e rasteve, se janë prona private dhe nuk ka territor që të vendosen panelet diellore, si dhe për faktin se në maja malesh është komplet e pamundur mirëmbajtja e tyre nga dëmtimet, nga thyerjet e qëllimta, nga mbulimi i dëborës. Nuk duhet të harrojmë se ne kemi pika të cilat 3-4 muaj në dimër, nuk i arrijmë dot. Kështu që e vetmja rrugë e sigurt është ndërtimi i depozitave dhe gjeneratorët.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Një nga sistemet me erë i do nja 1 milion euro investime.

Pse ka ndodhur rënia e të ardhurave nga tarifa?

Ka pothuajse një vit që RTSH-ja me shkresa zyrtare i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe OSHE-së që të bëjmë një takim tresh, që të bëjmë rakordimet se sa mblidhen realisht dhe sa derdhen realisht. Ne nuk e dimë dhe nuk kemi arritur ende që t'i ulim në një tavolinë Ministrinë e Financave dhe OSHE-në bashkë me ne.

Sa për të ardhurat minore tonat, nga shërbimet tona, unë them që pjesa e luanit e shërbimeve tona, që nuk mblidhet, është paraja që ne duhet të merrim nga rrjeti i digjitalizimit, në qoftë se nuk po na përkthehet investimi në lekë, pa u mbyllur transmetimet analoge.

Ne sot transmetojmë vetëm në Tiranë, mbështesim rreth 15 kanale private dhe asnjë prej këtyre nuk paguan asnjë qindarkë dhe po qe se do t'i mbyllim, do të shkaktojmë një problem vërtetë të dëmshëm për politikën dhe për publikun, prandaj duhet që AMA të mbyllë këto dhe të fillojnë pagesat.

Dihet se qeveria ka marrë vendim që t'i mbështesë me buxhet televizionet private me një pagesë për një vit. Me sa kam dëgjuar nga AMA, po bëhet një përpjekje dhe më duket se këto para do të vijnë shpejt, por ne që nga viti 2016 kemi pësuar vetëm humbje nga kjo gjë, jo vetëm se kemi mbajtur transmetime *multicast* (edhe analogë, edhe digjitalë), madje digjitalë në dy drejtime, T dhe T2, por edhe nga mosarkëtimi i parave nga televizionet lokale.

Përpara se t'ia jap fjalën Pandit, do t'i përgjigjem pyetjes për *Champions League*. Duhet ta theksoj se kjo është shumë e shtrenjtë. Me sa dimë ne, nga platforma private TRING është blerë, nuk e di mire, nja 6-7 milionë euro dhe këto janë evenimente që jepen në platformat



“Pay”, pra ata që duan ta shikojnë, duhet ta paguajnë. Nuk mundet që RTSH-ja të investojë për këtë gjë aq shumë, se nuk ka para. Nëse do t’i kishim paratë, ne mund të blinim shumë evente sportive, por ne nuk i kemi paratë.

Bëmë përpjekje shumë të mëdha vitin e kaluar që të binim dakord me TRING-un, që të merrnim, të paktën, një ndeshje të *Champions League* dhe arritëm edhe një akord me një çmim të caktuar. Rëndesë ishte për ne, por menduam se këto ndeshje mund të na ktheheshin në reklamë, sepse janë shumë të ndjekura. Problemi është se platformat private sot e shikojnë RTSH-në pak si kërcënim, ndaj nuk e pranuan marrëveshjen me ne.

Ne nuk po marrim dot kampionatin shqiptar të futbollit dhe prapë për të njëjtën arsyes, se nuk po e transmetojmë superioren dhe megjithëse kemi bërë përpjekje të mëdha dhe kemi arritur një gjysmë marrëveshje me platformat private, prapëseprapë Federata ka ndikuar që RTSH-ja të mos japë asnjë ndeshje të superiores, në të kundërt që ne transmetojmë gjithë ndeshjet e kategorive më të ulëta, duke i dhënë një ndihmë shumë të madhe Federatës Shqiptare të Futbollit dhe është e padenjë sjellja që bëjnë ata në drejtim të transmetuesit publik.

A mendon RTSH-ja për një strukturë permanente për të kontrolluar shikueshmërinë?

Kemi bërë një studim, sepse e kemi të domosdoshme këtë strukturë. Kjo strukturë nuk është njerëzore, por është një strukturë teknologjike. Kjo gjë kërkon një investim që shkon diku te 200 mijë euro, si dhe nevojitet edhe një kompani që të bëjë një studim se ku do të vendosen smart-dekoderat, që të lexojnë se çfarë ndjekin shikuesit më shumë apo më pak.

Nuk është ndonjë shumë e madhe, që të themi se kjo nuk do të bëhet, por përpara shumë nevojave të tjera më të domosdoshme, shumë vrimave që janë të hapura, kjo na duket se mund të presë pak në radhë.

**Pandi Madhi** – Ne insistojmë që të ardhurat nga shitja e produkteve të veta të RTSH-së të rriten dhe, për këtë arsye, edhe në buxhetin e vitit 2019 është parashikuar të rritet dhe të shkojnë në 57 milionë lekë, nga 41 që është realizuar në këto dy vjetët e fundit.

Ka një përmirësim krahasuar me vite më pare. Mundësitë mendoj se janë, por këto nuk luajnë ndonjë rol shumë të madh në një buxhet prej rreth 2,4 miliardë lekë, 16 milionë janë pak. Megjithatë, ne insistojmë që kudo që të jetë, edhe sikur 500 mijë lekë apo 1 milionë lekë, ne duhet të insistojmë që t’i realizojmë këto të ardhura.

Lidhur me të ardhurat e trashëguara nga një vit në tjetrin, theksoj se këto të ardhura janë thjesht të papërdorura, është diferenca e të ardhurave me shpenzimet gjatë një viti, që për institucione të nivelit të RTSH-së, ashtu si shumë institucione të tjera, nuk janë institucione me qëllim fitimi dhe nuk mund të thuash që realizuan fitim. Ato konsiderohen si të ardhura të pashpenzuara dhe menjëherë këto të ardhura, që janë në llogarinë që ka RTSH-ja në banka,

llogariten dhe përfshihen në buxhetin e vitit të ardhshëm. Ne kemi transferuar nga viti në vit, por dua të përmend se këto të ardhura kanë ardhur në zbritje dhe më 1 janar të vitit 2019 këto të ardhura ishin 57 milionë lekë. Dy vjet përpara ishin 266 milionë lekë dhe tani janë 57 milionë lekë. Të mos harrojmë se me këto të ardhura bëhen edhe pagesat e rrogave të datës 2 janar, që zënë rreth 40-50 milionë lekë në muaj, paguhen edhe sigurimet shoqërore e kështu me radhë.

Pra, këto të ardhura e kanë destinacionin për t'u përdorur gjatë muajit janar dhe janë një rezervë shumë pozitive.

Ne, si bord, po i shikojmë muaj pas muaji të gjitha pagesat, të gjitha shpenzimet që duhen kryer, duke vendosur radhën e tyre. Pra, nëse disa vjet më parë kishim një lloj rezerve në këto të ardhura të trashëguara, tani këto të ardhura sa vijmë e reduktohen, madje mund të shkojnë edhe zero në fund të viti, në qoftë se nuk do të kemi realizim të ardhurash që, siç po duket edhe nga tremujori i parë, po vazhdon e njëjta tendencë. Kemi mosrealizime me OSHE-në, si dhe disa mosrealizime të tjera brenda të ardhurave të RTSH-së, por që do t'i analizojmë brenda këtij muaji, se është edhe detyrë jona që t'i analizojmë muaj pas muaji treguesit financiarë të RTSH-së.

Faleminderit!

**Milva Ekonomi** – Urdhëroni, zoti Fadil!

**Fadil Nasufi** – Nuk kam pyetje, zonja kryetare, por dua të them se rekomandimet e raportit të monitorimit, duhet të përfshihen te raporti që do të vijë në Kuvend, si dhe relacionet që bëri relatori Ulqini.

**Milva Ekonomi** – Më falni, Fadil, ne nesër kemi takimin për rezolutën, kështu që rezoluta do të ketë të përfshira të gjitha detyrat që ne i japim RTSH-së për vitin në vijim.

**Fadil Nasufi** – Dakord.

E dyta, duhet që RTSH-ja të publikojë faqen e vet *web*, sepse i shërben.

E treta, në gjykimin tim, në misionin që ka RTSH-ja për informim, edukim, argëtim, te fusha e edukimit duhet të ketë më shumë kontribut edhe për ligjshmërinë, por edhe gjithë përmbajtjen e reformave që kryen shoqëria, sepse është i vetmi institucion që edhe kalkulon, edhe i shërben më me prioritet çështjes, sepse të tjerët janë në treg për spektakle dhe për gjëra më të marketuara në interesin e vet, si media private.

Bashkohem me vërejtjen që bëri zonja Kumbaro në lidhje me antenat, se i kemi problem edhe në Berat, ku ka zona të pambuluara, për të cilat duhet të investohet nga RTSH-ja.

Buxheti nuk ishte fort i kënaqshëm për vitin 2018, ndaj mendoj se qeveria duhet ta mbështesë më fort RTSH-në.

**Milva Ekonomi** – Urdhëroni, zonja Kumbaro!

**Mirela Kumbaro** – Zoti drejtor, ju kam pyetur para disa kohësh si deputete e qarkut të Gjirokastrës për mbulimin në zonën e Dropullit, sidomos në pjesën e Sotirës, se aty ka pasur një antenë.

A ka ndryshuar gjendja apo vazhdon të jetë e njëjtë? Do të doja një informacion.

Faleminderit!

**Thoma Gëllçi** – Më keni pyetur kur bëhej fjalë për transmetimet analoge. Unë jua kam shpjeguar edhe atëherë se transmetimet analoge, me ndarjen e re territoriale të Shqipërisë, të gjitha stacionet, përforcuesit e transmetimeve analoge kaluan në varësi të pushtetit vendor. Kur u bë ndryshimi nga komuna në bashki, ato mbetën në mëshirë të fatit.

Ne kemi bërë maksimumin e mundshëm që në transmetimet analoge të rikthejmë sinjalin. Nuk mund të të jap një përgjigje konkrete, por ne tashmë kemi sinjal të plotë numerik digjital në Dropull e kudo, ndërkohë që ato duhet të ishim mbyllur në bazë të strategjisë sonë, por theksoj se kemi transmetim të pastër numerik digjital në Dropull.

**Milva Ekonomi** - Faleminderit!

Besoj se nuk ka më pyetje të tjera.

Duke lexuar raportin tuaj, duke lexuar edhe raportin e Shërbimit të Monitorimit, por edhe nga pyetjet që bëmë e që na u sqaruan, edhe pse unë s'e mora përgjigjen e sondazhit, e kuptoj se keni plan që ta bëni.

Ne kemi edhe një mbledhje tjetër nesër, që lidhet me miratimin e rezolutave edhe për ju, edhe për AMA-n. Ndërsa, nga çështjet që kanë dalë këtu, besoj që do të na duhet të bëjmë një takim midis jush, AMA-s dhe operatorëve lokalë, sepse kjo çështje është e bartur që nga vera e vitit të kaluar. Ndërkohë ka një situatë që AMA kërkon vazhdimisht që ju të prezantoni disa çmime, të cilat edhe ju vetë i keni të vështirë t'i masni.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Gjithashtu, unë mendoj se ajo që ne, si komision, duhet të bëjmë, nëse ju kolegë bini dakord, lidhet me faktin se disa nga ju kërkuan ristrukturim të programeve dhe unë besoj se drejtori nuk mund ta bëjë këtë gjë vetëm, nëse nuk e mbështet Këshilli Drejtues, prandaj mendoj se mund të ishte në të mirë të punës që ne, si komision, t'i drejtonim një shkresë Këshillit Drejtues për nevojën e disa programeve që mund të vendosen në shërbimin e RTSH-së.

Nëse biem dakord, pasi të përfundojmë hartimin e rezolutave, javën që vjen, ulemi dhe hartojmë një kërkesë për këto nevoja që mendojmë se i shërbejnë popullatës.

*(Diskutime pa mikrofon.)*

Faleminderit shumë për pjesëmarrjen!

**MBYLLET MBLEDHJA**